



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Nr. 95/1 prot.

Tiranë, më 30.01.2023

**VENDIM**  
**Nr.3, datë 30.01.2023**

**PËR**  
**PËRFUNDIMIN E PROCESIT TË VERIFIKIMIT TË EKZEKUTIMIT TË**  
**VENDIMIT TË KOMISIONERIT NR. 86, DATË 15.06.2022.**

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenet 11, pika 1 dhe 14 të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, dhe Rregulloren, “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me Vendimin Nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, pas shqyrtimit të relacionit dhe mendimit paraprak të Drejtorit të Përgjithshëm të Inspektimit dhe Mbikëqyrjes dhe Drejtorit të Drejtorisë së Zbatimit të Vendimeve Paralajmëruese dhe Koordinimit, në lidhje me verifikimin e zbatimit të Vendimit Nr. 86, datë 15.06.2022, të Komisionerit, “Mbi përfundimin e procesit të vlerësimit të ligjshmërisë së aktit nr. 451 prot, datë 08.03.2022, të Drejtorisë së Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse, në Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimit të Provës Tiranë, për ushtrimin e përgjegjësisë për drejtimin administrativ të Degës Territoriale të Shërbimit të Provës Kurbin, prej nëpunësit civil \*\*\*\*\*”.

**KONSTATOVA SE:**

Nëpërmjet një kërkesë të regjistruar me nr. 238 prot, datë 25.03.2022, paraqitur nga nëpunësi \*\*\*\*\* , janë ngritur pretendime se janë lejuar paligjshmëri gjatë kryerjes së veprimit administrativ të transferimit të përkohshëm për interes të institucionit, të nëpunësit në fjalë, përmes aktit nr. 451 prot, datë 08.03.2022 të Drejtorisë së Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse, në Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimit të Provës Tiranë.

Pas shqyrtimit të të dhënave që përmbante informacioni i përcjellë, Komisioneri ka kryer hetimin administrativ mbi çështjen në fjalë.

Ky proces është përmbyllur me Vendimin nr. 86, datë 15.06.2022, të Komisionerit, “Mbi përfundimin e procesit të vlerësimit të ligjshmërisë së aktit nr. 451 prot, datë 08.03.2022, të Drejtorisë së Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse, në Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimit të Provës Tiranë, për ushtrimin e përgjegjësisë për drejtimin administrativ të Degës Territoriale të Shërbimit të Provës Kurbin, prej nëpunësit civil \*\*\*\*\*”.

Mbështetur në detyrat e lëna në Vendimin nr. 86, datë 15.06.2022, Drejtori i Përgjithshëm i Shërbimit të Provës, në kuadër të vlerësimit të ligjshmërisë së procesit të transferimit të përkohshëm për interes të institucionit, duhej të kryente veprimin të parashikuar në pikën 1, të Vendimit Paralajmërues, si më poshtë:

“Komisioneri ka kërkuar nga Drejtori i Përgjithshëm i Shërbimit të Provës që të anulojë aktin nr. 451 prot, datë 08.03.2022, “*Njoftim mbi ushtrimin e përgjegjësisë për drejtimin administrativ të Degës Territoriale të Shërbimit të Provës Kurbin...*”.

Në funksion të zbatimit të Vendimit Paralajmërues, Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil me shkresën nr. 776/4 prot, datë 12.12.2022, ka kërkuar informacion nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Provës mbi zbatimin e Vendimit Paralajmërues përkatës, si dhe dërgimin e dokumentacionit që materializon zbatimin e tij.

Drejtorja e Përgjithshme e Shërbimit të Provës me shkresën nr. 2309/1 prot, datë 23.12.2022, administruar nga Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil me nr. 776/12 prot, datë 29.12.2022, ka informuar se ndaj nëpunësit civil \*\*\*\*\* , Komisioni Disiplinor i ngritur pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit të Provës, me vendimin nr. 25, datë 01.07.2022, ka marrë masën disiplinore “*Largim nga shërbimi civil*”, pas shqyrtimit të shkeljeve të konstatuara nga Kontrolli i Lartë i Shtetit në Raportin Përfundimtar dhe Rekomandimet “*Mbi auditimin e përputhshmërisë*”.

Vendimi nr. 25, datë 01.07.2022, i Komisionit Disiplinor është ekzekutuar përmes urdhrin nr.100, datë 12.07.2022, të Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit të Provës, “*Për ndërprerjen e marrëdhënieve të punës dhe ato financiare, të nëpunësit civil \*\*\*\*\* me detyrë “Drejtore” në Degën Territoriale të Shërbimit të Provës Tiranë, në Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimit të Provës pas përfundimit të marrëdhënies në shërbimin civil për shkak të largimit nga shërbimi civil, si masë disiplinore*”.

Masa disiplinore “*Largimi nga shërbimi civil*” përbën një nga rastet e përfundimit të marrëdhënies së shërbimit civil, bazuar në gërmën “ç”, të nenit 58 dhe gërmën “b”, të nenit 63, të ligjit nr. 152/2013 “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar.

Nisur nga sa më sipër, ndodhur në kushtet kur marrëdhënia e shërbimit civil ka përfunduar, referuar nenit 95, të ligjit Nr. 44/2015 “*Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë*”, për shkak të pamundësisë në objekt apo qëllim, Komisioneri vlerëson se nuk ka më vend për të vijuar ndjekjen e zbatimit të detyrimeve të caktuara në Vendimin nr. 86, datë 15.06.2022, të Komisionerit.

#### **PËR KËTO ARSYE:**

Bazuar në nenet 11, pika 1 dhe 14 të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar; ligjin nr. 44/2015 “*Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë*” dhe Rregulloren, “*Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit*”, miratuar me Vendimin Nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

## VENDOSA:

1. Përfundimin e procesit të verifikimit të zbatimit të Vendimit Nr. 86, datë 15.06.2022, të Komisionerit, *“Mbi përfundimin e procesit të vlerësimit të ligjshmërisë së aktit nr.451 prot, datë 08.03.2022, të Drejtorisë së Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse, në Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimit të Provës Tiranë, për ushtrimin e përgjegjësisë për drejtimin administrativ të Degës Territoriale të Shërbimit të Provës Kurbin, prej nëpunësit civil \*\*\*\*\*”*.
2. Konstatimin e pamundësisë në objekt apo qëllim për ndjekjen e zbatimit të detyrimeve të Vendimit Nr. 86, datë 15.06.2022.
3. Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Provës dhe njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore e këtij institucioni, të tregojnë kujdes që në të ardhmen të zbatojnë me përpikëri ligjin dhe aktet nënligjore në fuqi për shërbimin civil, si dhe detyrat e lëna nga Komisioneri në Vendimin Paralajmërues.
4. Për këtë vendim të njoftohet Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Provës, e cila ngarkohet me detyrimin e njoftimit të këtij vendimi nëpunësit \*\*\*\*\*.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KOMISIONERI**

**Pranvera Strakosha**